

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje produkte ushqimore, perime, fruta dhe produkte të ngjashme me to për nevojat e Qendrës Ditore për të Moshuarit”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- **Drithëra, Patate, Perime, Fruta dhe Arra – (03200000-3)**
- **Produkte ushqimore të ndryshme – (15800000-6)**

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,085,583 (një milion e tetëdhjetë e pesëmijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa përfshirë vleftën e TVSH-së.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Delvinë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1, të shoqëruar me listën e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1, (Shtojca 7) e DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesi bilancet vjetore, për vitet financiare përkatësisht 2020 dhe 2021, ku bilanci i secilit vit nuk duhet të ketë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020 dhe 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve sipas ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", nenit 41, pika "c", e ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, në zbatim të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim xhiroje vjetore të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur në qoftë se Operatori Ekonomik arrinë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë

30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" etj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Dëshmi për furnizime të ngjashme të mëparshme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, për të cilën konkuron operatori ekonomik, që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si më poshtë:

- a. Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një Ent publik, kontrata furnizimi dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë në emër të tij Licencën me kodin II.1.A.1 "Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz". Në rastet kur operatorët ekonomikë, nuk kanë detyrim ligjor të licencohen nga Qendra Kombëtare e Biznesit me këtë licencë, duhet të paraqesin e Ekstraktin Tregtar të subjektit, ku në fushën e veprimtarisë së tij të jetë i përfshirë edhe objekti që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në **Rekomandim Nr. 10181 Prot., datë 19.11.2018, "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore"** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

2.3.3. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me:

* Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, ose ekuivalente me to.

* Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018, ose ekuivalente me to.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në **Rekomandim Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Kriteri për certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, është vendosur në bazë të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion certifikimet e duhura për mallrat objekt prokurimi.

2.3.5 Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të vetëdeklarojnë që produktet e kërkuara plotësojnë standartet në fuqi për sigurinë ushqimore.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në **Rekomandim Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore në fuqi.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në **Rekomandim Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

2.3.7 Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues i produkteve si bukë, vezë, qumësht dhe nënprodukte të tij, mish dhe nënprodukte të tij, duhet të paraqesë kontratë noteriale furnizimi për këto produkte.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në **Rekomandim Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

2.3.8 Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojnë 1 (një) automjet për kryerjen e furnizimit të ushqimeve si bukë, fruta, perime, etj. Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit, siguracionit të mjetit, pagimin e taksave vjetore, kryerjen e kontrollit teknik vjetor. Në rastin e disponimit të mjetit me qera duhet të paraqes kontratën noteriale të qerasë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5 gërma “ç” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë është vendosur bazuar në objektin e prokurimit, kriter i nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë (me anë të një deklarate), që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi në vendin e dorëzimit të kontratës (magazina e Bashkisë Delvinë), brenda afatit të përcaktuar në Dokumentave Standarte të Tenderit për lëvrimin e mallit.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor në formulimin e këtij kriteri kërkon prej Operatorit Ekonomik (Përfaqësuesit të subjektit) një deklaratë me anë të së cilës deklaron se merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi deri në vendin e ekzekutimit të kontratës (magazina e Bashkisë Delvinë), pa përfshirë kosto shtesë për këtë shërbim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor Bashkia Delvinë për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim: Në rastet kur citohet në specifikimet teknike termi “Cilësia e parë”, ose “Cilësi e mirë” ky përcaktim është i barasvlefshëm me termin “ekuivalentë”.

NJËSIA E PROKURIMIT